



Prishtinë: 27.10.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1439_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2231_09_21** të dt. 08.09.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 08.10.2021;

në seancën e mbajtur më datë **27.10.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e konsumatorit S.G nga Komuna e Rahovecit.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2231_09_21, i datës 08.09.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 08.09.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2231_09_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit S.G nga Komuna e Prishtinës, lidhur me kontestimin e korigjimit të dt. 30.04.2019.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori S.G, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Vërtetim i gabuar i gjendjes faktike dhe aplikim i gabuar i normës pozitive;
- KESCO i ka faturuar konsumatorin sasinë e energjisë të cilën ai nuk ka mundur ta shpenzoj, sepse në njehsor kanë qenë të kyçur subjektet afariste;
- Konsumatori kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të anulohë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2231_09_21 i datës 08.09.2021 dhe lëndës ta kthej në rivendosje.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe se gabimisht janë aplikuar dispozitat ligjore pozitive (në fuqi), Bordi thekson, pasi që ka administruar të gjitha provat materiale, si në shkresat e lëndës, dhe e ka analizuar secilën prej tyre, ka gjetur se ankesa e konsumatorit është e pabazuar, për arsye si në vijim:



Departamenti i faturimit në KESCO me datë 29.05.2015 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën maj 2015 me **6,453 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **643.30€**. Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që t'i behet ri shqyrtimi i faturës për periudhën 05150DGJ-80006400 datë 29.05.2015 për shkak të leximit dhe faturimit të gabuar.

Pas ankesës së konsumatorit, me datë 05.06.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në Grupin Matës nr. 35778875 ku TL=00271,099 kWh dhe TU=00135,00 kWh si dhe të dhënat teknike të pikës matëse përfshi edhe konstanten llogaritëse C=30. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që gjatë verifikimit të pikës matëse është evidentuar se në harxhimet e konsumatorit është i lidhur edhe konsumatori Gëzim Thaqi si dhe ferma e pulave e Sali Thaqi. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar se është bërë rregullimi i lidhjeve dhe se për momentin çdo gjë është në rregull por që ekipi i KEDS-it nuk ka evidentuar se në çfarë njehsorë elektrik behet faturimi dhe leximi i konsumatorëve të cilët janë furnizuar përmes njehsorit të konsumatorit me shifër DGJ-80006400.

Me datë 30.04.2019 Departamenti i faturimit në KESCO përmes korrigjimit nr. 26358DGJ-80006400 ka bërë korrigjimin e faturës për periudhën maj 2015 në vlerë monetare **-527.25€** duke ja minusuar konsumatorit **(-5451.48kWh)** nga **6,453 kWh** e faturuar. Bazuar në raportin e komisionit për korrigjim vërtetohet se kemi të bëjmë me faturim të dyfishtë ku të konsumatori me shifër DGJ-80006400 kanë qenë të kyçur edhe dy konsumatorë me shifër DGJ-80010259 dhe DGJ-80010853.

Andaj, faktin se ka pasur kyçje ilegale, KESCO e ka evidentuar në procesverbale, e i njëjti është konstatuar në vendimin e kontestuar, për këtë arsye konsumatori është korrigjuar për faturën maj 2015, duke ia minusuar -527.25 EUR, nga 643.30 EUR sa ka qenë kjo faturë.

Bordi i ZRrE-së ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 3. *Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese, dhe se është bërë shqyrtimi edhe i faturës kontestuese për periudhën 04/2014 pasi që edhe nga komisioni është vërtetuar se kemi grumbullim të kWh dhe konstaton se konsumatori për këtë periudhë është faturuar me kWh të grumbulluar nga periudha 02/2013. Bordi i ZRrE-së pajtohet me konstatimin e DMK-së për shpërndarjen e kWh të faturuar në periudhën 04/2014 për periudhën 02/2013 deri në periudhën 04/2014 dhe konstaton se konsumatorit nuk i takon korrigjim financiar.*

Bazuar në të gjitha analizat e bëra konstatohet se KESCO me rastin e faturimit të konsumatorit në periudhën 04/2014 dhe 05/2015 nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për*



konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.

Andaj, në harmoni me nenin 48 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Bordi i ZRRE-së i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe i ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe provat që lidhen më rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit S.G dhe
- Arkivit të ZRRE-së.